



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

PËRDORIMI I DATABAZAVE TË MËDHA PËR TË PROPOZUAR INTERVENIME DREJT BARAZISË NË ARSIM

Edukimi mbetet akoma sfida më e madhe e të gjitha vendeve në zhvillim. Në fakt, edukimi e determinon edhe zhvillimin e njëvendi, por edhe konceptin e shtetit. Studimet ndërkombëtare tregojnë që Kosova renditet në fund të listës kur flasim për arsimin (OECD, 2015, 2018). Në testet ndërkombëtare si PISA, nxënësit e Kosovës tregojnë rezultate të dobëta në të gjitha fushat e vlerësuara. Në këtë drejtim, pandemia COVID-19 vuri në pah edhe më shumë të metat në sistemin e arsimit të Kosovës duke shpërfaqur edhe pabarazitë. Të dhënat nga databazat e mëdha si këto të PISA të vitit 2015 dhe 2018 mundësojnë identifikimin e problemeve qendrore në sistemin e arsimit dhe adresimin e tyre përmes politikave dhe intervenimeve të bazuara në evidencë. Andaj, aktualisht në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", janë duke u realizuar disa hulumtime që në focus kanë të dhënat e PISA dhe TIMSS për të përshkruar situatën aktuale dhe (pa)barazinë në arsim.

Rezultatet e pritura nga hulumtimet me databaza të mëdha

Hulumtimet do të publikohen në formën e një libri në kuadër të projektit EduReaKos që implementohet nga Universiteti i Graz në partneritet me fakultetet e edukimit të universiteteve publike në Kosovë. Secili hulumtim do të jetë kapitulli veçantë në libër me tematika që trajtojnë çështje si teknikat e mësimdhënies në shkollë, performance në të lexuar, kënaqshmërinë me të mësuarit, motivimin, dallimet gjinore, dhe krahasimin e të dhënave të tjera demografike. Nga këto studime synohet të publikohet një libër që ofron një analizë të mirëfilltë të situatës nga të dhënat aktuale që kemi, propozimin e rekomandimeve politike dhe praktike për përmisimin e sistemit arsimor në Kosovë, dhe mundësitë e reja për ndryshim dhe udhëheqje në arsim në nivel të shkollave dhe akterëve të tjerë të përfshirë.